

Duke besuar në vullnetin tuaj për të shtyer përpara këtë proces të stagnuar për shumë vite padrejtësisht, besoj fuqishëm që kjo do të ishte një prej rrugëve të zhbllokimit të nyjes politike të kësaj çështje thellësisht teknike.

- **Percjellja e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë**

Me qëllim që marveshjet bilaterale të nënshkruara ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë të fillojnë së zbatuari. Unë si Zv. Ministër I Diasporës dhe Investimeve Strategjike jam ngarkuar nga Ministri I Diasporës z.Dardan Gashi me punë për percjelljen e zbatimit te marveshjeve bilaterale me Republikën e Shqipërisë si në vijim;


1. Marrëveshja për qendrat Kulturore të përbashkëta;
2. Marrëveshja për financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shiptare në diasporë.

Në këtë drejtim kemi pas disa takime shumë domethënëse dhe jemi në rrugë te mirë që të fillojmë ti zbatojmë marrëveshjet ashtu si kemi marë obligime si Ministri e Diasporës e Republikës se Kosovës dhe Ministria për Diasporën e Republikës se Shqipërisë, në keto fusha. Shumë shpejtë do të takohen grupet punuese të dy Ministrive që të ulen dhe ti harmionizojnë planet për ti zbatuar marrëveshjet e nënshkruara dhe të fillojnë themelimin e Qendrave Kulturore Shqipëtare në Diasporë. Gjithashtu shumë shpejtë do të fillojmë me regrutimin e Mësuesve te Gjuhës dhe kulturës Shqipëtare.

I respektuari z.Kryeminister.

Ky është Raporti im për 90 ditë te punës sime si zv.Ministër në Ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

**Me respekt,**



**Arian Daci**

**Zv.Ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike**

industria e sigurimeve në Kosovë që do të marrin përsipër obligimet për automjetet që vijnë nga BE.

4. Kemi filluar kontaktet e para me Byron e Sigurimeve te Republikës së Austris. Po shpresojme se takimin e parë me Byron e Sigurimeve te Austris ta kemi përafërsisht në muajin Prill. Ku atje do të takohemi se bashku me Ministrin e Diaspores dhe Investimeve Strategjike z.Dardan Gashi dhe të arrijmë marveshje memorandum mirëkuptimi për lëvizje të lire, që do të ishte një hap shumë i randësishëm për Kosovën dhe Bashkatdhetarët tanë . Kështu edhe Kosovarët do të ken mundësin që të paisen me Karton të Gjelbërt edhe në Kosovë, pasi që tani më janë dy Kompani të Sigurimeve qe veprojnë në Kosovë nga Austria. Ato jane Uniqua Group Austria (Sigali) dhe AustriaGroup(Sigma). Pastaj do të vazhdojmë punën për të filluar bisedimet me shtetet tjera, pikërishte me Zvicrën dhe Republikën e Gjermanisë
5. Të Inicojmë nënshkrimin e Memorandum Mirëkuptimin – MOU me Malin e Zi. MOU-të e lëvizjes së lirë me fqinjët janë një ndër kushtet e kërkuara për pranim të Kosovës në Këshillin e Byrove Nacionale, dhe ky do të jetë një hap para pranimit të Kosovës në Kartonin Gjelbër. Duhet theksuar se Kosova ka të nënshkruar MOU me Shqipërinë, Maqedoninë dhe me Serbinë, dhe është më se e domosdoshme të nënshkruhet ky memorandum edhe me Malin e Zi. Rekomandoj që Kryeministri Haradinaj gjatë takimeve me Kryeministrin e Malit të Zi të kërkojë nënshkrimin e kësaj marëveshje me të cilën do të hiqet blerja e polisave kufitare për veturat Kosovare dhe anasjelltas që udhëtojnë për dhe nëpër Mal të Zi.
6. Edhe nëse nuk arrijmë të anëtarësohemi plotësisht në Byron Nacionale të Sigurimeve (Kartonin e Gjelbërt) – këtë do të mund ta realizojmë me marrëveshje - Memorandum Mirëkuptimi për lëvizje të lirë për një kohë tranzitore, gjerësa Kosova të jetë anëtare e OKB-së, gjë qe Byroja Nacionale e Sigurimeve nuk do të na pengon.

Për të realizuar qëllimin e lartpërmendur,ne në ekip kemi konsultuar ekspertët më të mirë që ka Kosova në fushën e Sigurimeve dhe kemi angazhuar ata në ekipin tonë. Me kënaqesi kanë shpreh gadishmërin që të kontribojnë në zgjidhjen e këtij problemi që na preokupon si Qeveri e Kosovës.

Më lejoni të Ju informoj për punën time.

Me datë 15.12.2017 kam pranuar në takim z. Blerim Pushkolli, Drejtor Ekzekutiv në Byronë Kosovare të Sigurimeve BKS, me të cilin kemi biseduar shumë detajisht lidhur me ecurinë e gjithë procesit të anëtarësimit të Kosovës në Kartonin e Gjelbër, fazën në të cilën momentalisht gjindet ky proces si dhe procedurën të cilën e ka ndjekur BKS deri tani për të realizuar këtë qëllim. Z. Pushkolli, përpos informimit të detajuar gjithashtu më ka dërguar me postë elektronike disa material, si:

Korrespondencat mes Këshillit të Byrove në Bruksel dhe më ka njoftu se së shpejti do të fillojnë implementimin e Memorandum mirëkuptimi të nënshkruar në mes MDIS , MPB dhe BKS për shitjen e policave kufitare Online për bashkatdhetarët tanë . Kjo blerje e policave kufitare është vetëm një fazë e përkohshme, deri në pranimin e Kosovës në Kartonin e Gjelbërt.

Duke u mbështetur në hulumtimin dhe punë që kam bërë deri tani, rekomandoj hapat e ardhshëm:

1. Në Janar 2018 kam bërë përpjekje shumë serioze për të takuar Znj. Greet Flore, Sekretare Gjenerale e Këshillit të Byrove Nacionale të Sigurimeve me seli në Bruksel – ku do të informohemi drejtpërdrejt për hapat që duhet të ndjekim për anëtarësim.
2. Me 01.02.2018 jemi takuar me Sekretaren Gjenerale e Këshillit të Byrove Nacionale të Sigurimeve, znj. Greet Flore me seli në Bruksel. Në atë takim së bashku me Ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike z.Dardan Gashi, kemi marrë shumë sinjale pozitive nga znj.Flore, për zgjedhjen e problemit të Kosovës në Kartonin e Gjelbërt. Jemi dakorduar se si fazë kalimtare deri në antarësimin e Kosovës në Byron Nacionale të Sigurimeve (Kartonin e Gjelbërt), ne si Kosovë së bashku me Byron Kosovare të Sigurimeve të fillojmë të mundohemi të arrimë marrveshje Memorandum mirëkuptimi për lëvizje të lirë me shtetet e BE. Me Shtet që synojme marrveshje për lëvizje të lire janë Republika e Austris, Republika e Gjermanis dhe me Zvicrën, për shkak se atje kemi shumë bashkatdhetarë që jetojnë në keto shtete.
3. Të organizojmë një takim ku Kryeministri i Republikës së Kosovës z.Ramush Haradinaj së bashku me Guvernatorin e Bankës Qendrore, Drejtorin e BKS-së dhe disa Kompani të Sigurimeve në Kosovë, me qëllim të sigurimit të zotimit nga

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVË - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIT - URE E PRËMIERË - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Nr. Org. Org. Unit	01	Nr. Prot. Prot. No.	1059/20
Nr.faqeve No. pages	- 90 -	Data: Date	10/04/2018
Prishtinë / a			



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVA MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE - MINISTARSTVO ZA DIJASPORU I STRATEŠKA ULANJJA - MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS			
Nr. Org. Org. Unit	01-1	Nr. Prot. Prot. No.	351
Nr.faqeve No. Pages	04	Data: Date	10.04.2018
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateška Ulanjja - Ministry of Diaspora and Strategic Investments**  
**Kabineti I Ministrit – Kabinet Ministra – Cabinet of the Minister**

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO:		Ramush Haradinaj-Kryeministër i Republikës së Kosovës	
CC:		Dardan Gashi, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër I Diasporës Dhe Investimeve Strategjike	
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:		Arian Daci, Zëvendës Ministër I Diasporës Dhe Investimeve Strategjike	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Raport për muajt: Dhjetor 2017, Janar, Shkurt, Mars 2018	
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	109	Lokacioni: Kucni: Extension:	Rr. "Zenel Salliku", nr.4 Ndërtesa e ish Gjykatës Themelore në Prishtinë
		Data: Datum: Date:	10.04.2018

I nderuar Kryeministër z. Ramush Haradinaj,

Më lejoni që të ju përcjelli një Raport për 90 ditë pune në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

Duke qenë se jam ngarkuar nga Zv. Kryeministri dhe Ministri I Diasporës dhe Investimeve Strategjike me punë në hulumtimin e gjendjes momentale të çështjes së pranimit të Kosovës në Kartonin e Gjelbër, si dhe për të dhënë rekomandimet e mia për vazhdim të aktiviteteve në këtë drejtim. Gjithashtu jam ngarkuar për përcjelljen e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkuara në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në fushën e bashkëpunimit dhe unifikimit të Diasporës Shqipëtare.